

**STATUTI****I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR****“Brichton- Shpati” SH.P.K****KREU 1****Themelimi , Forma, Emri, Kohëzgjatja, Objekti dhe Selia****THEMELIMI I SHOQËRISË****NENI 1**

Duke u bazuar në ligjin nr 9901 date 14.04.2008 “Për shoqërite tregtare”, z. **Paç Shpati**, i biri i Gjon e Pashke Shpati, dtl. 23 Tetor 1975, lindur ne Shkoder, e banues Shkoder, ne adresen lagja “Perash” rruga “Daut Boriçi”, identifikuar me karte identiteti nr. leternjof. 033523997 dhe nr. vetjak H51023069N, dhe nën vullnetin e tij të lire i cili e shpreh dhe me nënshkrimin e këtij akti themelon shoq. “Brichton-Shpati” SH.P.K.

**FORMA E SHOQËRISË****NENI 2**

Kjo Shoqëri do jete Shoqëri Tregtare e formës Shoqëri me Pergjegjësi të Kufizuar “Brichton-Shpati” sh.p.k.

Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi si dhe atë civil, doganor, tatimor, fiskal dhe akte të tjera ligjore mbi bazën e aktit të themelimit dhe statutit të saj dhe normat e të drejtës nderkombëtare .

**KOHËZGJATJA E SHOQËRISË****NENI 3**

Kohëzgjatja e kësaj shoqërie do te jetë pa afat duke filluar nga dita e rregjistrimit në Q.K.R për njohjen dhe regjistrimin e shoqërise si person juridik.

**EMËRTIMI TREGTAR I SHOQËRISË**

Kjo shoqëri do të quhet “Brichton-Shpati” sh.p.k dhe vula e saj ka formën e saj në tëte cilën do shkruhet “Brichton-Shpati” sh.p.k.

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË****NENI 4**

**Objekti i veprimtarisë ekonomike te kësaj shoqërie do të jetë :**

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete: Tregtim me shumice dhe pakice, prodhim, import dhe eksport i materialeve te ndertimit, aksesoreve te gazit dhe materialeve hidraulike si dhe mallrave te lejuara nga ligji. Sipermarrje, Projektim dhe zbatim i projektesh per ndertim te objekteve civile dhe industriale. Strukturime, ristrukturime, rindertime, perdorje, te linjave e objekteve te ndryshme civile dhe industriale. Te bashkerendohet dhe te bashkohet me kushdoqofte tjeter shoqeri apo ndermarrje qe ka objekte te njejta me objektet e kesaj shoqerise. Te kontaktoje me persona fizike dhe juridike vendas ose te huaj per gjetjen e tregjeve te shitjes



per produktet dhe sherbimet e shoqerise. Import, tregti me shumice dhe pakice e bombolave te gazit te lengshem (GLN-se). Shitjen me pakice te lendeve djegese (gaz, naftë, benzin etj). Fushe magazinimi.

Per ato veprimtari qe kerkohet marrje license, kjo shoqeri do te pajiset me dokumentet perkates, sipas ligjit.

## **SELIA E SHOQËRISË**

Kjo shoqëri do ketë selinë e vet në adresën, Shkoder, Lagja Liria, Rruga Mbreti Gent, nr pasurie 17/111, zona kadastrale 8597. Shoqëria mund të hapë dhe filiale të tjera.

Per aktivitet ku kerkohet marrja e licenses, ortaku e administratori merr persiper qe te marre kete license brenda ligjit.

## **KREU 2**

### **Kapitali Themeltar, Organet e Shoqërise, Administratori, Eksperti Kontabël dhe Prishja e Shoqërisë**

#### **KAPITALI THEMELTAR**

##### **NENI 6**

Shuma e kapitalit themeltar të kësaj shoqërie është 100.000,00 leke, nr. i pergjithshem i kuotave 1,00; ky kapital eshte kontribut i ortakut te vetem z. Paç Shpati, te cilit zoteron 100,00 % te ketij kapitali. Kuota e kapitalit rregjistrohet ne librin e llogarise se shoqerise

Shoqëria çel llogari bankare në monedhën vendase (lek) si dhe në monedhën Euro (€) në banka vendase ose të huaja me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiarë të aktivitetit të saj.

Ortaku dhe administratori të caktuar nga shoqëria depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në bankat ku është çelur llogaria.

##### **NENI 7**

Pjeset e kapitalit themelor jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie, ne rast ndarje pasurore ndermjet bashkeshorteve, paraardhesve e pasardhesve. Nese do kete ortake, ne rast vdekje te tyre (ortakeve), pjesa e kapitalit qe disponon kalon te trashegimtarete e tij dhe kur asnjeri nga pjestaret e familjes nuk pranon te punoje ne ortakeri, atehere u jepen te gjithe fitimet qe u takojne sipas kontributit te derdhur ne kapitalin themelor. Te gjithe pjeset e kapitalit te shoqerise mund tu transferohen personave te trete, qe nuk bejne pjese ne ortakeri, por gjithmone me vendim te ortakut te vetem dhe me akt noterial. Trashegimtari hyn ne shoqeri me te gjithe te drejtat e detyrimet e ortakut.

##### **NENI 8**

Kapitali i shoqerise perbehet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros dhe mjete te tjera te nevojshme per ushtrimin e veprimtarise sipas objektit te percaktuar ne kete statut.

##### **NENI 9**

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarise ekonomike te shoqerise do te administrohet nga Ortaku i Vetem. Nje pjese e ketij fitimi mund te perdoret per zgjerimin e aktivitetit tregtar. Shoqeria eshte e detyruar te shlyeje te gjithe detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe te treteve.



**NENI 10**

Shoqëria është përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo mund të blejë të drejta të tjera materiale e jomateriale, duke përfshirë edhe të drejtën për shitjen e pasurisë së vet tek të tretët.

**NENI 11****ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI**

Organi vendimor i shoqërisë është Ortaku i vetëm. Ai vendos për çështje të tilla si emerimi ose shkarkimi i administratorit ose të administratorëve, ekspertëve kontabel të autorizuar dhe likuidatorëve, miratimin e raporteve të administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive, ndarja e fitimit, ndryshimet në statut, zvogelimi ose zmadhimi i kapitalit themelor, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, zgjatja e afatit të veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërrimi i shoqërisë në një formë tjetër, sipas ligjes, ndryshimi i vendndodhjes së selisë, dhe të çdo çështje që i njihet brenda kufinjve të ligjit ose me këtë statut.

**NENI 12**

Ortaku i vetëm mbledhjet e zakonshme i bën çdo vit, brenda katër muajve nga mbyllja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë.

**NENI 13****ADMINISTRATORI**

Administratori i shoqërisë është z. Paç Gjon Shpati.

Administratori qëndron në detyrë për afat 5 vjeçar të rinovueshem. Ortaku i vetëm gëzon të drejtën që të kryejë vetë edhe detyrën e administratorit ose të emerojë/shkarkojë në çdo kohë një person tjetër në atë detyrë.

Administratori ka këto kompetenca:

- përcaktimin e orientimeve kryesore të programit dhe buxhetit;
- miratimin e planeve dhe të llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre në bazë të objektit të aktivitetit të shoqërisë;
- përcaktimin e propozimeve dhe të varianteve të kapitalit që do të paraqitet ortakut të vetëm;
- përcaktimin e organikes drejtuese;
- krijimin e organizmave të tjera për realizimin e objektivave dhe funksioneve të shoqërisë;
- parapërgatitjen e propozimeve për ndërprerjen e aktivitetit të shoqërisë;
- përcaktimin e kërkesave të financimeve.

**NENI 14**

Administratori paraqet brenda 31 Marsit përfundimin e bilancit dhe llogarive ekonomike duke ja paraqitur ortakut të vetëm për miratim.

**NENI 15****VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE DHE REZERVAT E DOMOSDOSHME**

Çdo vit financiar fillon në 1 Janar të çdo viti dhe përfundon në 31 Dhjetor të po atij viti, me përjashtim të vitit të parë, ku si fillim është data e regjistrimit të shoqërisë.



**NENI 16**

Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e vitit financiare dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratoret, apo nga ekspertet kontabel, miratohen nga ortakut i Vetem. Miratimi i dokumentave financiare vjetore bëhet brenda një afati 3-mujor, mbas datës së mbylljes së vitit financiar.

**NENI 17**

Mbas miratimit të llogarive vjetore dhe vertetimit të egzistencës së fitimit, Ortaku i Vetem vendos e krijon fondin ligjor, por mund të krijojë edhe fonde të tjera. Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhjes së sigurimeve shoqërore etj. Ai ka të drejtë të çeli llogari likuiduese pranë bankave të vendit dhe të kryej veprime likuidimi me to.

**NENI 18****MARDHENIET E PUNESIMIT DHE LIDHJA E KONTRATAVE**

Mardheniet e punesimit brenda shoqërisë rregullohen nepermjet kontratës së punesimit, që lidhet midis paleve në përputhje me ligjet e Kodin e Punes, si dhe legjisllacionit tjetër shqiptarë që bën fjalë për punesimin.

**NENI 19**

Marrja në punë bëhet me regjistrimin nga punedhësi në librin e punës së shoqërisë, si dhe duke njoftuar organet e punës të juridiksionit ku ushtron veprimtarinë shoqërore.

**NENI 20**

Largimi nga puna bëhet me mbarimin e kontratës së punës, për shkelje disiplinore, ose me vete kërkesën e të interesuarit. Largimi nga shoqëria bëhet mbasi janë shlyer të gjithë detyrimet materiale e monetare. Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës bëhet në bazë të një akti me shkrim të leshuar nga ortakut i vetem themelues.

**NENI 21**

Shoqëria mund të lidhi kontrata me sektore shtetërore, drejtperdrejt në tregun e lirë, si dhe me persona fizike ose juridike, vendas ose të huaj.

Në veprimet kontraktuale, brenda dhe jashtë vendit, shoqëria përfaqësohet nga asambleja e ortakëve, ose nga një person tjetër i autorizuar prej saj.

Të drejtat e detyrimit që rrjedhin nga kontratat janë të detyrueshme për shoqërinë.

**NENI 22****DISPOZITA TE TJERA TE PERGJITHSHME**

Shoqëria mund të prishet para afatit të përcaktuar në këtë statut, në rastet kur ndryshon afati, ose kur ka një prishje të parakoheshme për shkak të tjera.

**NENI 23**

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi emërohen një ose disa likuidatorë, të cilët ndjekin operacionet e likuidimit deri në fund, dhe i paraqesin Ortakut të Vetem dhe administratorit rezultatet përfundimtare të likuidimit. Në përfundim ortakut i vetem vendos për heqjen e mandatit të tyre. Ortaku i vetem, që është dhe administrator, merr përsipër për t'i shlyer me kapitalin e tij të gjitha detyrimet që dalin nga likuidimi.



**NENI 24**

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise, kur nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, do te zgjidhen nga Gjykata e Shkodres.

**NENI 25**

Ndryshimi i shoqerise ne nje shoqeri tjetër behet me vendim te Ortakut te Vetem, kur plotesohen kushtet per krijimin e shoqerive te llojeve te tjera.

**NENI 26**

Themeluesi i shoqerise mund te beje ne çdo kohe ndryshime e plotesime ne statut dhe ne aktin e themelimit, pa rene ndesh ne menyre thelbesore me nenet e pershkruara ne kete statut. Ndryshimet e plotesimet behen ne te njejten menyre e proçedure me te cilen nxirret vete statut.

**NENI 27**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne përputhje te plote me ketë statut dhe me ligjin shqiptar "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" No. 9901 dt. 14.04.2008.

Per te gjitha çeshtjet e tjera te patrajtuara ne kete statut, veprimtaria e shoqerise do te mbeshteten vetem ne legjislacionin shqiptar ne fuqi, sipas rastit konkret. Referenca do te jene ligjet e legjislacionit shqiptar ne fuqi, perfshire edhe aktet ligjore e nenligjore te dala ne zbatim te tyre.

**NENI 28**

Ky statut, i cili permban pese faqe, eshte perpiluar dhe firmosur ne pese kopje.

**Ortaku i vetem**

**Paç Shpati**

Paç Shpati  


Shkoder dt. 15.01.2018